

Vendim nr. 310 datë 18.12.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Marjana Semini,	Anëtare
Marsida Xhaferllari,	Anëtare

në datën 18.12.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 11 (L) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: LEONARD ELEZAJ, përfaqësuar nga avokat Artan Zeneli, me akt përfaqësimi.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 842, datë 27.04.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nr. 521, datë 10.07.2018 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2024-355, datë 29.02.2024 të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën. Kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë ose në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 41, 42, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “f”, 132, pika 1 dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Leonard Elezaj është proceduar penalisht në mungesë së bashku me 2 individë të tjerë. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. 11, datë 11.02.2008, e ka deklaruar fajtor kërkuesin për veprat penale të vrasjes me paramendim për interes, të kryer në bashkëpunim dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuara nga nenet 78/2 e 25 dhe 278/2 të Kodit Penal (KP), dhe e ka dënuar me burgim të përjetshëm. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr. 20, datë 15.04.2008. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2010-517 (293), datë 26.03.2010, ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatave të faktit dhe deklarimin fajtor të kërkuesit për veprat penale të vrasjes me paramendim dhe të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuara nga nenet 78/2 e 278/2 të KP-së dhe dënimin përfundimisht të tij me 25 vjet burgim. Gjatë gjykimit, kërkuesi është përfaqësuar nga një mbrojtës i zgjedhur.

2. Sipas kërkuesit, në datën 28.08.2017, pas 28 ditëve nga hyrja në fuqi e ndryshimeve ligjore të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të miratuara me ligjin nr. 35/2017, ai ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë kërkesë për rishikimin e vendimit të Gjykatës së Lartë. Kërkuesi ka pretenduar se është gjykuar në mungesë, rrethanë e cila parashikohet si shkak për rishikim nga ndryshimet ligjore të KPP-së dhe se disa akte të prokurorisë ishin të pavlefshme për shkak të kompetencës lëndore.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, pasi ka analizuar faktet e çështjes dhe ligjin e zbatueshëm, me vendimin nr. 842, datë 27.04.2018, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim, me arsyetimin se nuk plotësohej asnjë prej kushteve të nenit 450/e të KPP-së. Sipas asaj gjykate, kërkuesi është gjykuar, në mungesë, sipas përmbajtjes që neni 352 i KPP-së kishte në kohën e gjykimit; kërkesa për rishikim është paraqitur jashtë afatit ligjor-30 ditor, i cili fillon nga dita e marrjes dijeni të vendimit dhe jo nga dita e hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore; ndërsa pavlefshmëria e akteve nuk përbën shkak për rishikimin e vendimit të formës së prerë.

4. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur ankim, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 521, datë 10.07.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin se kërkuesi ka pasur dijeni për procesin penal në ngarkim të tij, madje rekursi që ka vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë, e cila ka gjykuar çështjen e tij në themel, është ushtruar personalisht prej tij. Sipas gjykatës së apelit, megjithëse kërkuesi është gjykuar në mungesë, ai është konsideruar i pranishëm, pasi ka qenë i mbrojtur dhe i përfaqësuar nga mbrojtësi i zgjedhur.

5. Po kështu, edhe Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2024-355, datë 29.02.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit, me argumentin se ai nuk përmban asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Sipas saj, gjykatat e faktit kanë marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuarit mbështetur në dispozitat ligjore procedurale të zbatueshme, ndaj shkaqet e paraqitura prej tij në rekurs janë të haptazi të pabazuara.

6. Në datën 25.10.2024, kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar bazuar në parashikimet e ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 14.11.2024.

II

Pretendimet e kërkuarit

7. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se gjykatat i kanë cenuar *të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

- 7.1. *E drejta për t'u dëgjuar personalisht e lidhur me gjykimin e drejtë*, pasi ndryshimet ligjore të KPP-së i njohin personit të gjykuar në mungesë të drejtën për rishikimin e vendimit, pa e lidhur me faktin nëse kishte dijeni për gjykimin e çështjes së tij apo nëse kishte zgjedhur një mbrojtës vetë.
- 7.2. *E drejta për akses*, pasi kërkesa për rishikim nuk mund të kufizohet në kohë. Ai është njohur me vendimin e dënimit në momentin e ekzekutimit të tij në datën 30.03.2016, ndërsa e drejta për rihapjen e procesit i është njohur në datën 01.08.2017, pasi ndryshimet e KPP-së kanë hyrë në fuqi. Ndonëse ai e ka paraqitur kërkesën menjëherë sapo kjo e drejtë iu dha nga vetë ligji, ky fakt nuk është marrë në konsideratë nga gjykata.
- 7.3. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat nuk kanë arsyetuar faktin nëse ka të drejtë një person që i fshihet drejtësisë të kërkojë rishikimin e vendimit përfundimtar. Ato kanë krijuar konfuzion në drejtim të dijenisë dhe caktimit të mbrojtësit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

8. Çështja e legjitimitimit është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

10. Kolegji vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në Gjykatë, ndaj justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

11. Një tjetër kriter paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Në rastin në shqyrtim, në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka kundërshtuar edhe vendimin e Gjykatës së Lartë, i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor të nisur prej tij për rishikimin e procesit penal që e ka deklaruar atë fajtor dhe e ka dënuar me 25 vjet burgim. Në këtë situatë, Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka më mjete të tjera ankimi ndaj vendimit të kundërshtuar, për rrjedhojë e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

12. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Gjykata ka pohuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 29.02.2024 dhe është publikuar në faqen zyrtare të asaj gjykate në datën 27.06.2024 (shih shkresën nr. 4494/1 prot., datë 23.09.2024 të Gjykatës së Lartë), ndërsa ankimi kushtetues individual është dërguar nëpërmjet shërbimit postar në datën 25.10.2024. Duke konsideruar datën 27.06.2024 si ditën që kërkuesi ka konstatuar cenimin e të drejtave themelore të tij, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

14. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar se vendimet gjyqësore që nuk kanë pranuar kërkesën e tij për rishikimin e vendimit përfundimtar të Gjykatës së Lartë që e ka deklaruar atë fajtor dhe e ka dënuar me burgim, në mungesë, janë rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor në aspektet e së drejtës për t'u dëgjuar personalisht, së drejtës për akses dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor. Kolegji vëren se ndonëse këto pretendime *prima facie* hyjnë në juridiksionin e Gjykatës, argumentet e tyre, në thelb, lidhen me interpretimin dhe zbatimin e ligjit procedural penal për sa u takon kriterëve për pranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit përfundimtar, atribut ky që u njihet gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 42, datë 29.05.2024; nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*), sikurse rezulton i ushtruar edhe në rastin në fjalë.

15. Në kontekst të sa më sipër, Kolegji çmon se shkaqet e paraqitura nga kërkuesi për pranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit përfundimtar të dënimit janë marrë në shqyrtim, analizuar dhe vlerësuar në mënyrë të arsytuar nga gjykatat, të cilat i kanë kthyer përgjigje në mënyrë shteruese, në respektim të elementeve të së drejtës së tij për proces të rregullt ligjor. Në këto rrethana, Kolegji çmon se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae*.

16. Si përfundim, bazuar në arsytimin e mësipërm, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk i plotëson kriteret për kalimin për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.